



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_.2017

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1374, DATË 10.10.2008 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE,  
QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË  
FONDIT KULLOSOR" TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar", me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në Vendimin nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", të ndryshuar, bëhen disa ndryshime:

1. Në të gjithë tekstin e vendimit, emërtimi "Ministria e Mjedisit" zëvendësohet me "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit".
2. Pika 6, ndryshohet si më poshtë vijon:  
*"6. Kërkesa shoqërohet me dokumentin e planimetrisë të sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit".*
3. Në pikën 15, shkronja "c" shfuqizohet.
4. Pika 17 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1374, DATË 10.10.2008 “PËR RREGULLAT DHE PROÇEDURAT QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR” TË NDRYSHUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Amendimi i këtij projektvendimi plotëson kuadrin nënligjor, i cili do të mundësojë lehtësimin e procedurave për subjektet e interesuara për heqje të fondit kullor për shkak të ushtrimit të aktivitetëve ekonomike të miratuara paraprakisht nga një Ministri e linjës.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje me programin e Qeverisë dhe në funksion të iniciativës për të lehtësuar procedurat për qytetarët, dhe nuk cënon mirëadministrimin e fondit kullor publik.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon të përcaktojë rregullat për paraqitjen e kërkesës dhe plotësimin e dokumentacionit teknik si dhe procedurat e zvogëlimit të të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË  
DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI  
VENDAS E NDËRKOMBETAR

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe del në bazë dhe për zbatim të ligjit 49/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me legjislacionin evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË  
PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga 4 pika, ku cilësohen ndryshimet që i duhen bërë Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1374, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” të ndryshuar, konkretisht:

1. Në të gjithë tekstin e vendimit, emërtimi “Ministria e Mjedisit” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.
2. Meqënëse shkronjat “a”, “b” dhe “d” të pikës 6, shfuqizohen, atëherë pika 6, ndryshohet si më poshtë vijon:  
“6. Kërkesa shoqërohet me dokumentin e planimetrisë të sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit”.
3. Në pikën 16, shkronja “c” shfuqizohet, pasi dokumenti I kërkuar në këtë pikë është i njëjtë me dokumentin e shfuqizuar në pikën 6, shkronja “b”.
4. Njëkohësisht shfuqizohet edhe pika 17.

amendimi i këtij projektvendimi duhet të shoqërohet patjetër me dixhitalizimin e informacionit nga Ministrinë e linjës, të cilat miratojnë veprimtari mbi fondin pyjor dhe kërkojnë heqjen e këtij fondi për pasojë. Deri sa të kryhet ky proces i dixhitalizimit në mbarë vendin, drejtoria përkatëse në MTM do të ndjekë vetë dhe të koordinojë të gjithë procesin me Ministrinë përgjegjëse për miratimin e veprimtarisë, duke lehtësuar qytetarin për dorëzimin e dokumentacionit të kopjes së noterizuar të lejes apo të dokumentit, me të cilin i është miratuar veprimtaria, nga institucioni i ngarkuar me ligj.

#### VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Kryetarët e Bashkive dhe Ministrinë e linjës që kërkojnë heqje nga fondi kullosor, për zbatimin e këtij vendimi.

#### VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Nisma e propozuar për projektvendimin është një nismë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kuadër të iniciativës së Qeverisë Shqiptare, për të lehtësuar procedurat e marrjes së dokumentave nga qytetarët. Hartimi i këtij projektvendimi është realizuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit. Projektvendimi u dërgua nëpërmjet sistemit e-akteve për komente në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë shprehur parimisht dakort. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk është shprehur për këtë projektvendim, edhe pse ka kaluar afati ligjor i dhënies së komenteve. Duke qënë se projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, e konsiderojmë se ky institucion nuk ka komente. Lidhur me komentet e Ministrisë së Drejtësisë, sqarojmë se:

“Për disa ndryshime në Vendimin nr.1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave, “për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” të ndryshuar”.

1. Komentin për rivlerësimin e titullit të projektvendimit u reflektua në projektvendim;
2. Komentin në lidhje me përmbajtjen e shkronjës "c" të pikës 16, u reflektua në projektvendim, duke e shfuqizuar edhe këtë kërkesë të pikës 16. Pra, shkronja "c" e pikës 16 u shfuqizua.
3. Lidhur me komentin për sqarimin nëse procesi i dixhitalizimit do të realizohet në kohën e hyrjes në fuqi të këtij projektvendimi, ju bëjmë me dije se deri sa të kryhet ky proces i dixhitalizimit në mbarë vendin, drejtoria përkatëse në MTM do të ndjekë vetë dhe të koordinojë të gjithë procesin me Ministrinë përgjegjëse për miratimin e veprimtarisë, duke lehtësuar qytetarin për dorëzimin e dokumentacionit të kopjes së noterizuar të lejes apo të dokumentit, me të cilin i është miratuar veprimtaria, nga institucioni i ngarkuar me ligj.

#### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Efekti financiar është parashikuar në momentin e miratimit të ligjit 49/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar"